



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3208/2 prot.

Gramsh, më 09/08/2022

VENDIM

Nr. 64 dt. 31/08/2022

PËR

“ Miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesat e shtetasve Rexhep dhe Çlirim Liçi, banorë në fshatin Kabash, Njësia Administrative Poroçan, si dhe dëmshpërblimin financiar të këtyre familjeve”.

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 31.08.2022, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, sektori i Emergjencave Civile dhe “Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesat e shtetasve **Rexhep dhe Çlirim Liçi**, banorë në Fshatin Kabash, Njësia Administrative Poroçan, si dhe dëmshpërblimin financiar”, bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjin 45/2019 “Për mbrojtjen civile”;
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor për dëmet ndërtimore si dhe ato në pajisje e orendi të hartuar nga specialistët e Bashkisë Gramsh.
2. Të miratojë vlerën e dëmshpërblimit financiar bazuar në V.K.M. Nr. 329 datë 16.5.2012 të përlogaritur bazuar në dëmet e shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë, për shtetasin **Rexhep Liçi** në vlerën **1 094 221** (një milion e nëntëdhjetë e katër mijë e dyqind e njëzete e një) lekë.
3. Të miratojë vlerën e dëmshpërblimit financiar bazuar në V.K.M. Nr. 329 datë 16.5.2012 të përlogaritur bazuar në dëmet e shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë, për shtetasin **Çlirim Liçi** në vlerën **636 355** (gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e treqind e pesëdhjetë e pesë) lekë.

4. Ti akordoj familjes së shtetasit **Rexhep Liçi** , ndihmën emergjente në vlerën **1 094 221** (një milion e nëntëdhjetë e katër mijë e dyqind e njëzete e një lekë nga buxheti i bashkisë Gramsh, fondi i Emergjencave Civile i destinuar dhe i miratuar nga Këshilli i bashkisë për vitin 2022.
5. Ti akordoj familjes së shtetasit **Çirim Liçi** , ndihmën emergjente në vlerën **636 355** (gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e treqind e pesëdhjetë e pesë) lekë nga buxheti i bashkisë Gramsh, fondi i Emergjencave Civile i destinuar dhe i miratuar nga Këshilli i bashkisë për vitin 2022.
6. Ndihma financiare për familjet e shtetasve Rexhep dhe Çirim Liçi, përcaktohet sipas kritereve të VKM-së nr.329, datë 16.05.2012.
7. Ndihma financiare që do të akordohet do të përdoret për ti ardhur në ndihmë familjeve të shtetasit Rexhep dhe Çirim Liçi, banesa e të cilëve është dëmtuar nga rënia e zjarrit.
8. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike (Sektori i Emergjencave Civile), si dhe Drejtoria e të Ardhurave, Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar.

Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

Sekretari i Këshillit të Bashkisë

XHULIA GJINI

Konceptoi: Xh. Gjini
Pranoi: G. Lena
Konfirmoi: G. Lena
Dosja nr: _____
Afati i ruajtjes:

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

GRETA LENA

